

TERMAT E REFERENCES PËR STUDENTËT PJESËMARRËS NË TRAJNIM

“QASJA PËR TË MËSUAR JASHTË AUDITOREVE PËR PËRMBYTJET NË SHQIPËRI’ 2017”

Cfarë është BRIGAIID?

BRIGAIID është akronim i “BRIdging the Gap for Innovations in Disaster Resilience” e shqipëruar “Kapërcimi i barrierave në fushën e novacionit në funksion të rekuperimit nga katastrofat”

Qëllimi i projektit BRIGAIID është të përthithë ide inovative mbi 3 komponentë kryesorë të ndryshimeve klimatike si:

PËRMBYTJET, THATËSIRAT dhe MOTI EKSTREM.

Mes ideve të ndryshme, projekti do të përzgjedhë disa prej tyre (ato më premtueset), të cilat do të zhvillohen dhe do të testohen. Idetë e sukseshme do të mbështeten për të dalë në treg e për t’u bërë i mundur implementimi i tyre, në rolin e katalizatorit apo eliminuesit të dëmeve të mundshme, në raste të fatkeqësive natyrore.

QËLLIMI I PUNËS

Muaji dhjetor filloj me një përballje të njerëzimit me forcën e natyrës, përmbytjet e datës 02 dhe 03 Dhjetor 2017. Qëllimi i kësaj vizite në terren ka në fokus pikërisht këto përmbytje. Situata emergjente dhe zonat e prekura nga dalja e disa lumenjve prej shtretërve të tyre është një indikator për të zhvilluar një vizitë në terren dhe për të parë nga afër si njerëzit përballin këto fatkeqësi, sa të vegjël e gjejnë ata veten kundrejt një force aq madhore sa ajo e Natyrës.

Projekti BRIGAIID si një facilitues për kapërcimin e katastrofave natyrore, kërkon të mësoj nga afër dhe të përfshijë në ciklin laboratorik të tij realitetin si një e dhënë për të prodhuar novacione adequate por dhe anasjelltas.

METODOLOGJIA


Skuadra e përzgjedhur (dy koordinator grupi dhe gjashtë studentë) do të zhvillojnë një sondazh prej një jave; gjatë të cilës do të vizitojnë dy prej zonave më të prekura gjatë përmbytjeve të muajit Dhjetor 2017 dhe do të intervistojnë dhe pyesin vetë banorët e prekur nga këto përmbytje. Në përfundim të kësaj vizite në terren të gjithë pjesëtarët e grupit të punës do të dorëzojnë pranë njësisë së projektit në Tiranë informacionin e grumbulluar.

Itenerari i lëvizjes së studentëve në terren:

GRUPI I PARË - VJOSA

Dita e Parë e Studimit në terren - Kashisht, Frakull-Levan, Darëzezë


Dita e Dytë e Studimit në terren - Novoselë, Bishan, Poro



GRUPI I DYTË- ISHËM - ERZEN

Dita e Parë e Studimit në terren - Katund i Ri, Sukth, Vorë

Dita e Dytë e Studimit në terren - Fushë-Krujë, Derven, Adriatik



Skuadra do të kryejë detyrat e mëposhtme:

- **Gjetje dhe grumbullim informacioni në terren:** Grupit do i vihen në dispozicion pyetësor në mënyrë që të mund të grumbullojnë të dhëna, ngjarje reale të përjetuara gjatë përmytjeve, histori të ndryshme sesi vetë banorët u mbrojtën dhe mbrohen nga përmytjet, foto të ndryshme, etj. Në kuadër të projektit të dy grupet do të kenë gjithashtu një pyetësor lidhur me risitë që ofron projekti BRIGAD, për të vlerësuar sa të përdorshme ose funksionale mund të jenë zgjidhjet alternative të BRIGAD për kapërcimin e katastrofave natyrore ku në këtë rast në fokus janë përmytjet.
- **Seleksionim dhe mirëmenaxhim i informacionit në terren:** Grupi në tërësinë e tij do të ketë një koordinator dhe tre studentë. Informacioni i cili do të gjeneroj nga terreni do të përpunohet dhe raportohet nëpërmjet e-mailit tek njësia e projektit BRIGAD, në AKPT. Informacioni nga terreni do të përpunohet dhe do të sistemohet për publikim. Të dhënat të cilat do të derivojnë nga ky studim në terren do të jetë në formën e pyetësorëve të plotësuar, tekstit, imazheve fotografike, videove, hartave, etj.

PRODUKTI PËRFUNDIMTAR

Produkti përfundimtar i këtij trajnimi do të vijë në trajtën e një botimi dygjuhësh i cili do të mbështetet në këto dy pika:

- 1- Të mësojmë nga përballja jetësore e forcës së natyrës **PËRMYTJET**.
- 2- **BRIGAD** një alternativë e nevojshme për përjasje në kuadër të kapërcimit të katastrofave natyrore.

AFTËSITË E KËRKUARA

Kandidatët duhet të kenë njohuri dhe edukim në **Hidrologji, Hidroteknik, Mjedis, Gjeomjedis dhe degë të tjera të ngjashme**. Të kenë eksperiencë në vëzhgime në terren, sondazhe. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe menaxhuese të informacionit.

Puna do të zhvillohet në grup, ndaj aftësia për të diskutuar aktivisht me kolegët është domosdoshmëri.

Përzgjedhja e kandidatëve:

Fazat e përzgjedhjes së kandidatëve do të jetë si më poshtë:

Faza e Parë- Përzgjedhja e aplikantëve të cilët do të shprehin interesin e tyre dhe që kanë dërguar dokumentat e kërkuara në adresën zyrtare të projektit (03.01.2018-08.01.2018);

Faza e Dytë- Aplikantët e përzgjedhur në fazën e parë do të kalojnë përmes një seksioni intervistash (08.01.2018-12.01.2018). Në këtë fazë do të përzgjidhen tetë student.